



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 709/41 prot.

Elbasan, me 20.03.2025

**VENDIM**

Nr 47 datë 20.03.2025

**Mbi miratimin e kuotave të pranimit, në programet e studimit të ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë", për vitin akademik 2025-2026**

Bazuar në Ligjin 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 3, neni 25, pika 7; neni 37, pikat 1 dhe 2, neni 38, pika 1, dhe pika 3, në VKM nr. 41, datë 24.01.2018 "për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar, pika 2.7, germa a,b,c, në statutin e UE-së "A. Xhuvani" neni 9, germa h, si dhe në Vendimin nr.43, datë 17.03.2025 të Senatit Akademik të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", "*Mbi miratimin e kuotave të pranimit, në programet e studimit të ciklit të tretë doktoratë, për vitin akademik 2025-2026*", Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës ....03.2025

**V E N D O S I :**

1. Të miratojë kuotat e pranimit në Universitetin e Elbasanit "A. Xhuvani" për vitin akademik 2025-2026, në programet e studimit ciklit të tretë të studimeve Doktoratë", gjithsej **13 kuota**. Kuotat e pranimit për kandidatë studentë brenda vendit: **12 kuota**. Kuota e pranimit për kandidatë studentë nga trojet: **1 kuota**.
2. Ky vendim i përcillet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Qendrës së Shërbimeve Arsimore.
3. Ngarkohet Administratori i Universitetit "Aleksandër Xhuvani" për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI  
Dr. Ardian DURMISHI